REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:046977
Datë: 06.06.2022
Numri i dokumentit: 03099791

Ac.nr.10405/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Frosina Sylejmani, kryetare e kolegjit, Arsim Hamzaj dhe Burim Shala, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses F.R, nga Gjilani, të cilën e përfaqëson me autorizim F.S, avokat nga Gjilani, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit, të cilën e përfaqëson me autorizim Burim Maliqi, për kompensimin e shpërblimit jubilar, kompensimin të shpenzimeve të ushqimit dhe të udhëtimit, duke vendosur sipas ankesës së të autorizuarit të të paditurës e paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr.813/2020, të datës 06.10.2021, në seancën jo publike të mbajtur me datë 31.05.2022, ka marr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa themeltë ankesa e të paditurës Komuna Gjilanit, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr.813/2020 i datës 06.10.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m i

Gjykata e shkallës së parë me Aktgjykimin e atakuar, ka vendosur si vijon:

"I.APROVOHET si e bazuar me ligj, kërkesëpadia e paditëses F.R nga Gjilani dhe detyrohet e paditura Komuna e Gjilanit, që paditëses, t'ia paguaj shumen e të hollave në emër te shpërblimit jubilar për 30 vite përvojë pune në vlerë të një page baze, në lartësi prej 421 €, në emër të kompensimit të shujtave të ushqimit, për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri me datën 21.01.2021, respektivisht për 718 ditë të pranisë në punë, shumën e të hollave në lartësi prej 1,436.00 euro, €, si dhe në emër shpenzimeve të udhëtimit për 812 ditë punë për 70% të biletës së trafikut urban shumën prej 502.60€, respektivisht shumën e përgjithshme prej 2,359.60, duke llogaritur kamatën prej 8% nga data 08.04.2020/ data e ushtrimit të padisë/ e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 7 ditë pas ditës së pranimit të këtij Aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm ligjor.

2021:281342

II. Detyrohet e paditura Komuna e Gjilanit, që paditëses t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestuese në lartësi prej 270 €, në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimit të këtij Aktgjykimi."

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor përfaqësuesi i autorizuar i të padituës ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën si të bazuar ashtu që Aktgjykimin e atakuar ta ndryshoj ose ta prish dhe lëndën ta kthej në rigjykim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur paditësja, përmes të autorizuarit të saj, duke propozuar që ankesa e të padituës të refuzohet si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet, si dhe të detyrohet e paditura që në emër të përpilimit të përgjigjes në ankesë t'ia paguaj shumën prej 104.00 €.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës se dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës të nenit 194 dhe 195, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa është e pa bazuar

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësja F.R, ka ushtruar padi, kundër të padituës Komuna e Gjilanit, duke kërkuar që të detyrohet e paditura që në emër të kompensimit të shujtave, prej periudhës 18.04.2017 e deri 21.01.2021, për 718 ditë pune, t'ia paguaj shumën prej 1,436.00 €, në emër të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit për 718 ditë pune, në vlerë të 70% të biletës kthyese, shumën prej 502.60 €, në emër të shpërblimit jubilar, për 30 vite përvoj pune, në vlerë të një page bazë, shumën prej 421.00 €, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, ka nxjerrë Aktgjykimin e atakuar me të cilin ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat janë pretenduar nga pala ankuese.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të autorizuarës së të padituës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi

2021:281342

2 pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, për faktin se nuk është kontestuese që paditësja është në marrëdhënie pune me të padituren në SHFMU "Iliria" në fshatin Pogragjë, Komuna e Gjilanit dhe atë në pozitën e mësimdhënëses të lëndës Gjuhë Shqipe , fakt që vërtetohet nga kontrata e punës Nr.prot474, e datës 01.09.2015. Po ashtu, nuk është kontestues fakti se paditësja për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri me datën 21.01.2021, ka qenë prezentë në vendin e punës për 718 ditë fakt i vërtetuar nga vërtetimi Nr.94/21 i datës 04.10.2021, faktin e vendbanimit dhe udhëtimit gjykata e shkallës së parë me të drejtë e bazon në çertifikatën e vendbanimit me nr. B 10256305 të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Gjilan dhe në vërtetimin e datës 03.06.2020, në të cilin vërtetohet fakti se bileta një drejtimëshe Gjilan – Pogragjë kushton 0.50 euro, dhe se paditësja i ka mbi 30 vite përvojë pune tek e paditura dhe ky fakt vërtetohet me vërtetimin nr.prot.134/2019 e datës 20.12.2019, ndërkaq me listën e pagave, të lëshuar nga Buxheti i RKS-së, vërtetohet se paga bazë e paditëses është në shumë prej 421.00 euro.

Gjykata e Apelit duke vlerësuar aktgjykimin e atakuar lidhur me pretendimet ankimore se gabimisht është aplikuar e drejta materiale gjeti se të njëjtat nuk qëndrojnë, ngase gjykata e shkallës së parë drejtë dhe bazuar në ligj i është referuar Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë dhe atë nenit 35 par. 5, nenit 35 par. 7 dhe nenit 35 par. 8 pika 3 dhe pika 5 të së njëjtës.

Me nenin 35 paragrafin 8 pika 3 dhe pika 5, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 përcaktohet se: "*Punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) në vitet jubilare të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, në vlerë 8.3. për 30 vjet të përvojës së punës në vlerë të një page bazë, 8.5. Shpërblimi jubilar paguhet nga punëdhënësi, kur i punësuari ka plotësuar kushtet e shpërblimit sipas kritereve përkatëse*". Në paragrafin 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, përcaktohet se: "*Të punësuarve u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim"* Në nenin 35 paragrafin 5 të kësaj Kontrate përcaktohet se: "*Punonjësit të kësaj Kontrate përcaktohet se arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70 % të biletave të trafikut urban".*

Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditëses, duke e obliguar të padituren që në emër të kompensimit të shpenzimeve për ushqim, për periudhën kohore prej datës 18.04.2017 e deri me datën 21.01.2021, t'ia paguajë shumën prej 1,436.00 euro, në emër

2021:281342

të shpenzimeve të udhëtimit, 70% të biletës, shumën prej 502.60 euro, në emër të shpërblimit jubilar për 30 vite përvojë pune, në lartësi prej 100%, të një page bazë shumën prej 421.00 euro, apo shumën e përgjithshme prej 2,359.60 euro, me të drejtë është bazuar në dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, të lidhur dhe nënshkruar nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK-ut) dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës (MASHT), e cila kontratë ka qenë në fuqi me rastin e parashtrimit të kërkesës për kompensimin e shpërblimit jubilar dhe shpenzimet e ushqimit dhe udhëtimit për ditët në punë, që rrjedhimisht nënkupton se kjo Kontratë shërben si akt nga i cili buron themelësia e kërkesëpadisë.

Pretendimin ankimor të të padituës, lidhur me shumat e gjykuara për ditët e pranisë në punë pas datës 18.04.2020, datë e cila e paditura pretendon se është data e skadimit të KKAK-së, Gjykata e Apelit, e refuzon si të pabazuar, pasi që duke u bazuar në nenin 45 të po kësaj kontrate në të cilin parashihet se " *Nga Kontrata Kolektive, palët mund të tërhiqen tre (3) muaj para skadimit të vlefshmërisë së saj, përmes letrës rekomanduese, e cila tërheqje fillon së zbatuari ditën e nënshkrimit të kontratës së re. Nëse nga Kontrata Kolektive pasi ti skadoj afati i përcaktuar, nuk tërhiqet asnjëra nga palët, zbatimi vazhdon edhe për një vit.",* në rastin konkret kërkesa e paditëses është mbuluar me zbatueshmërinë e kontratës së lartëcekur deri më datë 22.01.2021, kur është shfuqizuar Kontrata Kolektive e Arsimit e datës 18.04.2017 dhe është lidhur kontrata tjetër kolektive nr.prot.105 e datës 22.01.2021.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se në këtë rast ekziston detyrimi juridiko - civil, ndaj paditëses në emër të pagesës për kompensimin e shpërblimit jubilar si dhe shpenzimeve të ushqimit – shujtës gjatë ditëve të pranisë në punë, për arsye se me nenin 245 paragrafin 1 të LMD-së, përcaktohet se: "*Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij".*

Gjykata e Apelit, mori parasysh pretendimin ankimor të të padituës lidhur me faktin se Kontrata Kolektive e Arsimit nuk është obligative për të padituën, për arsye se nuk janë përmbushur kushtet e parapara me nenin 46 të kësaj Kontrate, meqenëse nënshkruesit e kësaj kontrate siç janë MASHT-i, SBASHK-u dhe Ministria e Financave nuk janë angazhuar asnjëherë për zbatimin e dispozitave që janë implikime financiare. Lidhur me këto pretendime, Gjykata e Apelit vlerëson se referuar dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, rrjedh se obligimi për përmbushjen e të drejtave të të punësuarve të parapara me këtë Kontratë, i takojnë pikërisht punëdhënësit, që në rastin konkret i bie të jetë e paditura. Në këtë pikëpamje, çfarëdo vështirësie që i atribuohet implikimeve financiare lidhur me zbatimin e kësaj Kontrate, nuk e liron të padituën nga përgjegjësia për përmbushjen e obligimit në raport me kërkesën e paditëses, gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpadia të trajtohet si e pa themeltë.

Gjykata e Apelit vlerësoi se gjykata e shkallës së parë, drejt ka aplikuar të drejtën materiale lidhur me afatshmërinë e padisë-gjegjësisht se kërkesa e paditësit nuk është parashkruar, për shkak se, në bazë të nenit 87 të Ligjit të Punës, me nr. 03/L-212 i dt. 01.11.2010, përcaktohet se: " Të

2021:281342

gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para parashkruhen brenda afatit prej 3 - vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës ” duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore dhe e cila ishte në fuqi në kohën e krijimit të raportit juridik, rrjedh se padia e paditësit është e lejuar dhe e ushtruar brenda afatit kohor.

Vendimi mbi kamatën e përcaktuar është në përputhje me dispozitën e nenit 382 të LMD-së, ndërsa vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitën nga neni 452.1 të LPK-së, ndërsa veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese janë arsyetuar drejtë, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Gjykata e Apelit, me rastin e vendosjes i vlerësoi pretendimet ankimore të së paditurës, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk janë me ndikim dhe peshë për një vendim ndryshe, andaj edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragrafi 1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.10405/21, me datë 31.05.2022

Kryetare e Kolegjit,
Frosina Sylejmani